

VENDIM
Nr. 403, datë 16.7.2025

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 348, DATË 29.4.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE
RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË NXITJES NËPËRMJET
VETËPUNËSIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 348, datë 29.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2, e kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Programi i vetëpunësimit mbështet sipërmarrjet e reja, nëpërmjet trajnimit për sipërmarrjet dhe zhvillimin e planeve të biznesit për kërkuesit, dhe grant për përfituesit.”.

2. Në kreun II bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas shkronjës “a”, të pikës 1, shtohet shkronja “a/1”, me këtë përmbajtje:

“a/1. Të mos ketë marrë pjesë më parë si punëkërkues i papunë në programet e nxitjes së punësimit në 5 (pesë) vitet e fundit.”;

b) Në pikën 4, fjalët “... në vlerën jo më shumë se 3 000 (tre mijë) lekë ...” zëvendësohen me “... në vlerën jo më shumë se 5 000 (pesë mijë) lekë...”;

c) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Programi subvencionon për të gjithë të përzgjedhurit si përfitues grantin për ngritjen e biznesit deri në masën 1 000 000 (një milion) lekë.”.

3. Në kreun III bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 3 bëhen këto ndryshime:

i. fjalia hyrëse riformulohet:

“Punëkërkuesi duhet të aplikojë *online*, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, për përfshirjen në program, duke plotësuar: ...”;

ii. shkronja “b” ndryshohet, si poshtë vijon:

“b) Vërtetimin për individ të peregjistruar.”;

b) Në pikën 14, fjalët “... brenda 5 (pesë) ditëve punë, ...” zëvendësohen me “... brenda 10 (dhjetë) ditëve punë ...”.

4. Në pikën 5, të kreut IV, togfjalëshi “... 5 (pesë) ...” zëvendësohet me “... 10 (dhjetë) ...”.

II. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

